



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:206960

Datë: 27.11.2019

Numri i dokumentit: 00682042

P.nr.994/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Divizioni Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale e përbërë nga gjyqtarja Mimoza Shabani, në çështjen penale kundër të pandehurit XH.A nga fshati ... Komuna Shtime, për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.1611-4/2019 e datës 18.09.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor fillestar dhe publik, në praninë e përfaqësuesit të akuzës - prokurorit të shtetit Ajtene Zoni, të pandehurit XH.A, si dhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar, me datë 25 Nëntor 2019 mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datë 27 Nëntor 2019, përpiloi me shkrim këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri: XH.A, i lindur me datë 22.02.1981, nga i ati H... e ëma T... e gjinisë H..., me vendbanim në Fshatin ... Komuna Shtime, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i tre fëmijëve i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 08.08.2019 rreth orës 06:30h, në vendin e quajtur “L...”, rajoni Ekonomiko Pyjor ... Komuna Shtime, me të cilin menaxhon Agjencioni Pyjor i Kosovës, i pandehuri së bashku me të miturin H.A me qëllim të vjedhjes së trungjeve në pyll kanë prerë me sharrë motorike 129 trungje drunjte të llojit ahu, me diametër 12-24 cm, të gjata 10-13 me vëllim të

përgjithshëm prej 8.11m³, me q'rast të dëmtuarës Agjencionit Pyjor të Kosovës i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 1240.83 €.

me të cilin veprim ka kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.2 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata në bazë dispozitës së lartë shënuar si dhe neneve 2,4,7,8,17,38,39,43, 46,47,48,49,69,70 dhe 71 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 370, 453,463, të KPP-së, të pandehurin XH.A e,

G J Y K O N

Dënim me gjobë, në shumë prej 300 /treqind/ Euro, të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe

Dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 /një/ viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 2 /dy/ viteve, nëse i pandehuri nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale.

Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 43 par. 3 të KPRK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro të gjobës së pa paguar, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Obligohet i pandehuri që në emër të kërkesës pasurore juridike, Agjencionit Pyjor të Kosovës, t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar në shumën prej 1240.83 Euro /njëmijë e dyqind e katërdhjetë e tetëdhjetë e tre cent/ në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse dëmi nuk kompensohet në afatin e caktuar më lartë, me propozim të palës së dëmtuar do të bëhet përmbarimi i detyruar.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 /njëzetë/ Euro, si dhe konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 /tridhjetë/ Euro,

brenda afatit prej 15 ditëve,nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit, ose do të bëhet përmbarimi i detyruar, sipas detyrës zyrtare.

A r s y e t i m i

1.Historiku procedurës dhe aktakuza

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën e evidentuar si:PP.II.nr.1611-4/2019 e datës 18.09.2019, ndaj të pandehurit XH.A për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.2 të KPRK-ës.

Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, duke vepruar në këtë çështje penale sipas nenit 245 të KPPRK-së, caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor fillestar me dt. 25.11.2019, dhe pas leximit të aktit akuzues, gjyqtari u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, konform nenit 246 par. 4 si dhe pas njoftimit sipas dispozitave të neneve 325 dhe 323 të KPPK-së, të pandehurit i ofroj mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

2. Pranimi i fajësisë nga i pandehuri

I pandehuri XH.A, në shqyrtimin gjyqësor fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, sipas të gjitha pikave të aktakuzës, kërkon falje publike duke shtuar se arsyeja pse kryen këto vepra penale është sepse është i gjendjes së dobët ekonomike, është i papunë dhe mbajtës i familjes, duke i propozuar gjykatës që ti shqiptoj një dënim sa më të ulët.

Prokurori i Shtetit Ajtene Zoni me rastin e paraqitjes së mendimit lidhur me pranimin e fajësië nga pandehurin, ka propozuar që të pranohet pranimi i fajësisë për të pandehurin, pasi pranimi fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe në përputhje me dispozitat ligjore të nenit 248 të KPRK-së si dhe provat materiale dhe faktet e çështjes.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar APK-së L.M, në shqyrtim gjyqësor fillestar ka deklaruar se e mbështetë fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit duke kërkuar nga Gjykata që të aprovohet kërkesa pasurore-juridike në shumë prej 1240.83 €.

3. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPRK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit si: fletëparaqitja e rojës së pyllit me numër 60-2019 e datës 02.09.2019, procesverbali i rojës së pyllit lidhur me vlerësimin e dëmit me nr. 35/2019 dt. 02.09.2019, deklarata e dëshmitarit M.M – roje pylli e dhënë në Prokurorinë Themelore në Ferizaj dt. 16.09.2019, fotografitë dhe provat e tjera që gjenden në shkresat e lëndës.

Me qenë se i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtari konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata po ashtu vërtetoi se prokurori ka disponuar me prova të mjaftueshme për veprën penale të të pandehurit dhe ka dhënë mendimin për pranimin e fajësisë nga ana e tij.

Gjykata vërtetoi përtej çdo dyshimi se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së, meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi, ku në vendin e quajtur “L...”, rajoni Ekonomiko Pyjor ..., me të cilin menaxhon Agjencioni Pyjor i Kosovës, i pandehuri së bashku me të miturin H.A me qëllim të vjedhjes së trungjeve në pyll kanë prerë me sharrë motorike 129 trungje drunj të llojit ahu, me diametër 12-24 cm, të gjata 10-13 me vëllim të përgjithshëm prej 8.11m³, andaj duke marrë parasysh se në veprimet inkriminuese të tij janë përmbushur elementet e veprës penale vjedhja e pyllit si dhe me këtë i ka shkaktuar dëm palës së dëmtuar, i njëjti është penalisht përgjegjës dhe është shpallur fajtorë për këtë vepër penale.

4. Caktimi i dënimit për të pandehurin

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, Gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69, 70, dhe 71 të KPRK-së, si rrethanë lehtësuese vlerësoi pranimin e fajësisë për veprën penale të kryer, e cila është bërë në seancën e shqyrtimit fillestar, pendimin real dhe të sinqertë, i gjendjes se dobët ekonomike, mbajtës i familjes, kurse

në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese përveç që vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, ndërsa me rastin e vlerësimi të rrethanave rënduese gjykata nuk gjeti në rastin konkretë.

Mbi bazën e këtyre rrethanave, gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar është në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të të pandehurit, duke marrë parasysh edhe faktin se i njëjti ka bërë pranimin e fajësisë, duke vlerësuar se me shqiptimin e denimit me gjobë edhe me sanksion penal alternativ-denim me kusht do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-ës, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë veprës penale dhe kryrësit, që do të shërbej në parandalimin të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

5. Kërkesa pasurore juridike si dhe shpenzimet procedurale

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, sepse e njëjta është precizuar nga pala e dëmtuar dhe nuk kontestohet nga i pandehuri.

Vendimi mbi shpenzimet paushall si dhe kompensimin e viktimave të krimit është marr në kuptim të dispozitës së nenit 453 par. 1 të KPPRK-së.

Nga arsyet e lartë shënuara u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,

Departamenti i Përgjithshëm,

P.nr. 994/19 me datë 27 Nëntor 2019

Gjyqtarja: Mimoza Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj, për Gjykatën e Apelit të Kosovës.

Numri i lëndës: 2019:206960
Datë: 27.11.2019
Numri i dokumentit: 00682042